

NEWSLETTER

Shkurt

Albsig

Ruajtja e Lidershit në Tregun
e Sigurimeve për 2024

Angazhimi i ALBSIG në
Aktivitetet Edukative dhe
Panairot e Punës

Albsig Invest

dhe Trajnimi mbi Fondet
e Pensionit Privat dhe
Fondet e Investimit



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguresit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 31 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Albsig Invest dhe Trajnimi mbi Fondet e Pensionit Privat dhe Fondet e Investimit.

Në kuadrin e përmirësimit të njohurive të stafit dhe përshtatjes me risitë e tregut financiar, Albsig Invest ka nisur një trajnim intensiv me temën "Risitë në Fondet e Pensionit Privat dhe Fondet e Investimit". Ky trajnim synon të forcojë njohuritë e punonjësve të Albsig mbi investimet afatgjata dhe mundësitë që ofrojnë këto fonde për klientët. Gjatë sesioneve, ekspertët e sektorit ndanë perspektivat e tyre mbi trendet e tregut, strategjitë e investimit dhe avantazhet që ofrojnë fondet për një të ardhme të sigurt financiare.





ALBSIG: Ruajtja e Lidershit në Tregun e Sigurimeve për 2024

ALBSIG, pjesë e Kastrati Group, vazhdon të ruajë dhe të forcojë pozicionin e saj si lider në tregun shqiptar të sigurimeve. Me një fokus të veçantë në cilësinë e shërbimeve dhe transparencën në trajtimin e dëmeve, ALBSIG ka arritur një performancë të shkëlqyer në disa kategori kryesore.

Lidership në Pagesën e Dëmeve dhe Efikasitetin e Shërbimeve

Sipas statistikave të publikuara nga AMF, ALBSIG ka numrin më të ulët të dëmeve të papaguara deri më 31 dhjetor 2024. Me vetëm **326 praktika pezull nga 17,157 dosje dëmsh të trajtuara dhe paguara**, kompania konfirmon përkushtimin për korrektësi dhe besueshmëri, duke rritur më tej besimin e klientëve.

Pozicionimi Kryesues në Produktet Kryesore të Sigurimeve

- ✓ **Sigurimi Kasko** — 38.10% e tregut
- ✓ **Sigurimi i Garancive** — 51.84% e tregut
- ✓ **Sigurimi i Përgjegjësive Civile** — 33.09% e tregut
- ✓ **Sigurimi i Përgjegjësive së Ndërtuesit** — 48.45% e tregut

ALBSIG vazhdon të ofrojë produkte inovative dhe të personalizuar për të mbështetur klientët në nevojat e tyre të sigurimit.

Rritja e qëndrueshme dhe dominimi në sigurimet vullnetare

Në vitin 2024, ALBSIG ka ruajtur **19.23% të tregut në sigurimet e përgjithshme**, duke mbetur lider në sigurimet vullnetare me **53.07%**, shumë mbi mesataren e tregut prej 32.85%.

Performanca në Sigurimet e Jetës

Në këtë segment, ALBSIG është renditur e dyta me **24.15% të tregut**, duke shënuar rritjen më të madhe në këtë kategori me **50.09% më shumë prime të shkruara bruto** krahasuar me vitin 2023. Ky progres reflekton strategjinë afatgjatë të kompanisë për të ofruar zgjidhje të sigurta financiare për klientët.

Vizioni për të Ardhmen

Duke investuar në inovacion dhe përmirësim të shërbimeve, ALBSIG synon të forcojë më tej pozicionin e saj në treg, duke ofruar produkte të personalizuar dhe një qasje të avancuar në menaxhimin e sigurimeve.



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

Angazhimi i ALBSIG në Aktivitetet Edukative dhe Panairët e Punës.

Simultane Shahu dhe Ping Pong në Maarif

Në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare Maarif, ALBSIG dhe dy shoqëritë e saj Albsig Jetë dhe Albsig Invest, organizuan një simultane shahu dhe ping pongu, ku punonjësit sfiduan nxënësit në këto sporte mendore dhe fizike. Kjo iniciativë kishte si qëllim promovimin e vlerave të disiplinës, strategjisë dhe sportit tek të rinjtë.



Pjesëmarrja në Tourism & Travel Show Albania 2025

Në këtë panair të rëndësishëm, i mbajtur në **Pallatin e Kongreseve**, ALBSIG prezantoi produktet e saj të sigurimit në udhëtim dhe paketat e dedikuara për turistët dhe bizneset në industrinë e turizmit. Përfaqësuesit e kompanisë patën mundësinë të komunikojnë drejtpërdrejt me operatorët turistikë, hotelet dhe individët e interesuar, duke theksuar avantazhet e sigurimeve të personalizuar për udhëtarët dhe bizneset turistike.



Panairi Work & Study 2025

Në datat **27-28 shkurt**, ALBSIG ishte pjesë e këtij panairi të rëndësishëm të karrierës dhe edukimit. Ky event është një mundësi e shkëlqyer për të prezantuar mundësitë e punësimit dhe zhvillimit profesional brenda kompanisë. ALBSIG ofroi informacion mbi pozicionet e hapura, trajnimet dhe mundësitë e karrierës në sektorin e sigurimeve, duke inkurajuar të rinjtë të bëhen pjesë e një kompanie me vizion dhe stabilitet në treg.



Nëpërmjet këtyre angazhimeve, ALBSIG vazhdon të mbështesë komunitetin, edukimin dhe zhvillimin profesional, duke u afirmuar si një kompani e përkushtuar ndaj inovacionit dhe shërbimit cilësor.



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL